



EKSTRAKTI I PROCESVERBALIT

të mbledhjes së parë të Kuvendit të Komunës së Prishtinës, mbajtur më 22.1.2014, e cila filloi në orën 10:00.

Në mbledhje morën pjesë: Shpend Ahmeti, Kryetar i Komunës, këshilltarët e Kuvendit të Komunës: Halim Halimi, Hazir Borovci, Sami Hamiti, Vlora Dumoshi, Feim Salihu, Agim Gashi, Shefki Gashi, Mustafë Krasniqi, Shaip Hajrizi, Abit Kastrati, Sokol Krasniqi, Bekim Gashi, Naime Osmani, Vjollca Dibra - Ibrahimimi, Ajnishahe Azemi, Hasime Krasniqi, Merita Surkishi, Flamur Shala, Sylejman Pireva, Genc Sherifi, Puhie Demaku, Hatixhe Hoxha, Qendron Kastrati, Yll Hoxha, Hatixhe Latifi - Pupovci, Teuta Krasniqi, Sadri Ramabaja, Lirak Çelaj, Memli Krasniqi, Blerand Stavileci, Shaip Shabani, Muhamet Selmani, Lirie Avdiu, Floriana Rugova, Laura Zherka, Remzi Pacolli, Islam Pacolli, Mirlinda Sopi, Sofije Bunjaku, Rita Begolli, Imer Rusinofci, Besa Rafuna, Fadil Gashi, Brahim Mehmetaj, Abetare Fazliu, Feti Mehdiu, Kimet Zeqa, Visar Arifaj, Nenad Miladinoviqi dhe Cuneyd Ustaibo.

Mungoi: Fisnik Ismajli.

Morën pjesë edhe drejtorët e drejtorive të Komunës, përfaqësues të Ministrisë së Pushtetit Lokal, përfaqësues të OJQ-ve, përfaqësues të mediave të shkruara dhe elektronike dhe përfaqësues të OSBE-së.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi anëtari më i moshuar i Kuvendit të Komunës, z. **Feti Mehdiu.**

U konstatua se njëzëri u miratua ky

REND DITE :

1. Miratimi i ekstraktit të procesverbalit të mbledhjes inauguruese;
2. Zgjedhja e kryesuesit të Kuvendit të Komunës së Prishtinës;
3. Themelimi i Komitetit për Politikë dhe Financa (KPF);
4. Caktimi i Grupit punues për hartimin e Planit vjetor të punës të Kuvendit të Komunës së Prishtinës për vitin 2014;
5. Propozimvendimi për zbatimin e Udhëzimit administrativ nr. 16/2008, për pagesat në stafin politik në komuna;
6. Të ndryshme.

Pika e parë

Njzëri u miratua ekstrakti i procesverbalit të mbledhjes inauguruese.

Pika e dytë

Lidhur me këtë pikë, kryesuesi në pika të shkurtra i njoftoi të pranishmit rreth zhvillimit të procedurës për zgjedhjen e kryesuesit të Kuvendit të Komunës.

Lidhur me këtë procedurë më konkretisht të pranishmit i informoi Agim Salihu, shef i Zyrës ligjore, duke thënë se sipas Udhëzimit administrativ 2009/1, për zgjedhjen e kryesuesit të Kuvendit të Komunës, është e paraparë që të formohet një komision për mbarëvajtjen e punës dhe mbikëqyrjen e procedurës së votimit të zgjedhjes së kryesuesit.

Kryesuesi kërkoi nga partitë politike që t'i japin propozimet e tyre për anëtarë të komisionit.

Nga GP i LDK-së u propozua Bekim Gashi, nga GP i Lëvizjes vetëvendosje (VV), u propozua Qëndron Kastrati, nga GP i PDK-së u propozua Muhamet Selmani, nga GP i AAK-LDD-së u propozua Fadil Gashi dhe nga GP i AKR-së u propozua Remzi Pacolli.

U konstatua se njzëri u formua Komisioni vlerësues, në përbërje prej pesë (5) anëtarëve, për mbarëvajtjen dhe mbikëqyrjen e procedurës së votimit për zgjedhjen e kryesuesit të Kuvendit.

Pas formimit të komisionit, **kryesuesi** kërkoi nga subjektet e partive politike që t'i japin propozimet e tyre për kryesues të Kuvendit.

Nga GP i LDK-së, për kryesues të Kuvendit u propozua **Halim Halimi**; nga GP i PDK-së, u propozua **Lirak Çelaj** dhe nga Lëvizja për Bashkim u propozua **Brahim Mehmetaj**.

Nenad Milladinoviq tha se ne nuk kemi kandidat për kryesues, do ta mbështesim kandidatin të cilin mendojmë se duhet të jetë në at pozitë.

Kryesuesi kërkoi nga Komisioni që të fillojë procedurën e votimit për zgjedhjen e kryesuesit të Kuvendit.

Gjatë procesit të votimit, z. Shefki Gashi pati një problem me fletëvotim dhe kërkoi nga Komisioni që t'i mundësohet votimi i serishëm.

Pas konsultimeve në mes të anëtarëve të komisionit, komisioni e pranoi kërkesën e z. Gashi që ai të votojë edhe një herë.

Pas përfundimit të votimit, kryesuesi i njoftoi të pranishmit se në kutinë e votimit ishin gjithsej 50 fletëvotime, pasi që një anëtar i Kuvendit ka munguar në seancë.

Bekim Gashi, në emër të komisionit për mbarëvajtjen e procesit të votimit, bëri kumtimin e rezultateve të votimit. Për kandidatin Brahim Mehmetaj, votuan 15 anëtarë, për kandidatin Halim Halimi votuan 26 anëtarë dhe për kandidatin Lirak Çelaj, votuan 9 anëtarë të Kuvendit.

U konstatua se me shumicën e numrit të përgjithshëm të anëtarëve të Kuvendit, z. Halim Halimi zgjidhet kryesues i Kuvendit të Komunës së Prishtinës.

Halim Halimi, kryesuesi i Kuvendit i falënderoi të gjithë anëtarët, të cilët i dhanë votën për kryesues të Kuvendit.

Pika e tretë

Lidhur me themelimin e Komitetit për Politikë dhe Financa, kryesuesi tha se sipas Ligjit për vetëqeverisje lokale dhe Statutit të Komunës, ekzistojnë dy komitete të përhershme të Kuvendit të Komunës, Komiteti për Politikë dhe Financa dhe Komiteti për Komunitete.

Komiteti për Politikë dhe Financa përbëhet nga 9 anëtarë, ku numri i anëtarëve propozohen në bazë të numrit të përgjithshëm të votave të subjektit politik, si në vijim: **LDK- 3, VV-2, PDK-1, AKR-1, AAK-LDD -1 dhe KDTP-1.**

Për anëtarë të Komitetit u propozuan: Halim Halimi, kryesues i Kuvendit, Sami Hamiti dhe Hazir Borovci nga GP i LDK-së, Yll Hoxha dhe Hatixhe Hoxha nga GP i Lëvizjes Vetëvendosje (VV), Islam Pacolli nga GP i AKR-së , Imer Rusinovci nga GP AAK-LDD, dhe Cuneyd Ustaibo nga subjekti politik KDTP.

Lirak Çelaj tha se GP i PDK-së mendon se kjo është një ndarje jo e drejtë, andaj kërkojmë sqarim lidhur me formulën përcaktuese në këtë ndarje. Mendojmë se një vend për ne, në raport me numrin e anëtarëve që kemi, është numër i vogël, andaj kërkojmë që ta shqyrtojmë edhe një herë këtë vendim. Nëse bëjmë krahasim me subjektet tjera, është komplet disproporcional, dhe ne konsiderojmë se kjo formulë na dëmton neve më së shumti dhe me këtë prishet barazia e përfaqësimit në këtë Komitet, i cili është komiteti kryesor. Ne insistojmë që fillimisht të përcaktohem si Kuvend se në bazë të cilit parim do të bëhet përfaqësimi në këtë komitet, pastaj të bëhet delegimi i anëtarëve.

Kryetari tha se nëse dikush ka probleme këtu dhe mendon se i është bërë padrejtësi, mund ta adresojë atë edhe te Ministria dhe pastaj Ministria vendos, siç ka ndodhur në disa raste në disa komuna të Kosovës. Është mirë që ta diskutojmë, por edhe pas votimit nëse ka pakënaqësi, prapë mund t'i drejtoheni Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal.

Agim Salihu i njoftoi të pranishmit për procedurën e themelimit të komiteteve të përhershme dhe komiteteve tjera joobligative, përbërjen, kompetencat dhe përgjegjësitë e tyre.

Sami Hamiti, në emër të GP të LDK-së, tha se kjo është formula më e saktë, e cila është aplikuar dhe aplikohet edhe këtu te ne, aplikohet edhe në nivel qendror, është formula zgjedhore e përpjesëtimit, që është në Ligjin zgjedhor. Është numri i përgjithshëm i votave të subjektit politik, përpjesëtohet me 3,5,7,9 dhe me atë përpjesëtim duhet të dihet që edhe një anëtar është nga radhët e komuniteteve.

Kimet Zeqa, në emër të GP të PD-së, tha se në këtë komitet nuk përfaqësohet asnjë femër, andaj do të ishte mirë që në çdo komision të jetë nga një anëtare femër.

Brahim Mehmetaj, në emër të GP të LB-së, propozoi që të zgjidhet një formulë gjithëpërfshirëse, e cila nuk është e ndaluar me ligj. Në ligjet në fuqi askund nuk përcaktohet formulë me të cilën do të zgjidhen anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa.

Yll Hoxha tha se duhet të kemi proporcionalitet në përfaqësim, andaj dhe duhet të arrijmë një marrëveshje për këtë, pasi që PDK-ja kundërshton këtë formulë, e cila është zbatuar në përzgjedhjen e këtij komiteti. Ai Kërkoj nga anëtarët e Kuvendit që të tregojnë mirëkuptim, që së pari nëse parimi i përfaqësimit me formulë kalon në këtë kuvend, atëherë PDK-ja do ta ketë më lehtë ta propozojë kandidatin për anëtar të Komitetit.

Shefki Gashi tha se nuk do të votojmë anekse të formulave, që do të thotë se nëse është e paraparë me formulë që vjen prej Ligjit për vetëqeverisjen lokale, ne nuk kemi të drejtë që ta votojmë.

Memli Krasniqi tha se nëse i referohemi Ligjit për vetëqeverisje lokale, konkretisht nenit 52, ku flitet për përbërjen e Komitetit për Politikë dhe Financa, thuhet se përbërja e tij duhet të reflektojë përfaqësimin e entiteteve politike në Kuvend të Komunes, por nuk përmendet formula.

Edhe Rregullorja për përbërje dhe kompetenca të komiteteve, neni 2, pika 2, thotë se anëtarësia në secilin komitet do të reflektojë sa më shumë që është e mundur me proporcionin e vendeve që kanë partitë politike dhe koalicionet në Kuvend të Komunes. Pra, vendeve e jo votave, dhe nuk është e njëjta gjë, këtë e din secili prej nesh.

Feti Mehdiu, shprehu mendimin se ky kuvend është meritore që t'i japë vizën opsionit, i cili është më i përshtatshëm për këtë kuvend dhe për qytetarët e Prishtinës. Partia e Drejtësisë mbështet mendimin se më e drejtë është gjithëpërfshirja, por Kuvendi mund ta vendosë se a do të shkojë me proporcion apo me gjithëpërfshirje. Mendoj se për këtë Kuvendi e ka obligim të deklarojë.

Agim Gashi tha se nuk mund të rritet numri i anëtarëve të Komitetit, pasi që këtë çështje e determinon rregullorja dhe nëse rritet numri, atëherë duhet të ndryshohet edhe rregullorja, e ndryshimi reflekton edhe në koston e saj.

Edhe përkundër sugjerimeve dhe sqarimeve të dhëna dhe konsultimeve me grupet parlamentare, GP i PDK-së mbetet në qëndrimet e veta, duke mos e propozuar anëtarin për komitet, e që konsideron se është kundër formulës së përfaqësimit, duke reflektuar proporcionin e vendeve që kanë partitë politike në Kuvendin e Komunes.

Me shumicë votash, 33 për, 4 kundër dhe 3 abstenime, u miratua Vendimi për formimin e Komitetit për Politikë dhe Financa.

Kryesuesi tha se ky vendim nuk bëhet i plotfuqishëm pa ardhur vlerësimi i ligjshmërisë për procedurat e miratimit të vendimit nga Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal. Nëse Ministria konstaton ose vendos që PDK-së t'i shtohet numri në dy anëtarë, atëherë ai propozim do të jetë pjesë e këtij vendimi të cilin e miratuam.

Pika e katërt

Lidhur me caktimin e grupit punues për hartimin e planit vjetor të punës së Kuvendit të Komunës së Prishtinës për vitin 2014, të pranishmit në pika të shkurtra i njoftoi Agim Salihu, duke cekur se sipas Ligjit për vetëqeverisje lokale, neni 40, pika 2 shkronja d, është paraparë që Kuvendi i Komunës ta ketë planin e punës. Për hartim të një plani të tillë nevojitet të formohet një grup punues.

Për anëtarë të grupit punues u propozuan: Halim Halimi, kryesues i Kuvendit, Shefki Gashi, nga GP i LDK-së, Yll Hoxha, nga GP i Lëvizjes Vetëvendosje (VV), Laura Zherka nga GP i PDK-së, Miranda Sopi, nga GP i AKR-së, Rita Begolli, nga GP i AAK- LDD-së, Abetare Fazliu nga GP i LB-së, Kimet Zeqa nga GP i PD-së, Visar Arifaj, nga subjekti politik i PF-së, Cuneid Ustaibo, nga subjekti politik i KDTP-së, Nenad Miladinoviqi, nga subjekti politik i GIS-së, dhe Zijadin Gashi, nga Sektori për punë të Kuvendit.

Njëzëri u miratua Vendimi për formimin e grupit punues për hartimin e planit vjetor të punës së Kuvendit të Komunës së Prishtinës për vitin 2014.

Pika e pestë

Për Propozimvendimin për zbatimin e Udhëzimit administrativ nr. 16/2008, për pagesat në stafin politik në komuna, të pranishmit i njoftoi Agim Salihu, duke cekur se çështja e pagesës dhe kompensimit është e rregulluar me Udhëzimin administrativ që daton nga viti 2008, dhe në këtë udhëzim janë precizuar pagat e stafit të kryetarit të komunës, të nënkryetarëve, të kryesuesit, të anëtarëve të Kuvendit dhe të drejtorëve të drejtorive të Komunës.

Njëzëri u miratua Vendimi për zbatimin e Udhëzimit administrativ nr. 16/2008, për pagesat e stafit politik në komuna.

Mbledhja mbaroi në orën 14:30.

**Procesmbajtësi
Zijadin Gashi**

**Kryesuesi i Kuvendit
Halim Halimi, jur. i dipl.**